



Datë: 27.11.2025
Numër Protokolli: 7682/2025

A.nr.1226/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1226/2025, të datës 25.06.2025, të parashtruar nga ankuesi E.H, kundër organit të punësimit: Komuna e Junikut, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132, paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datë 27.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.1226/2025, e datës 25.06.2025, e parashtruar nga ankuesi E.H.

II. Anulohet Njoftimi me numër protokolli 1-180/4329, i datës 11.06.2025, i Njesisë së Personelit, të Komunës së Junikut, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare për procedurën e pranimi më numër reference RN00017614, për pozitën e punës Zyrtar i Logjistikës, si dhe të gjitha veprimet e ndërmarra nga Komisioni i Pranimi në fazën e vlerësimit profesional, ndërsa, procedura e pranimi kthehet me fillim në fazën e vlerësimit profesional.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Junikut që në pajtim me dispozitat materiale të themeloj Komisionin e Pranimi, përgjegjës për zhvillimi e vlerësimit profesional të kandidatëve të përfshirë në listën e ngushtë, ndërsa *obligohet* Njësia e Personelit të Komunës së Junikut që të ndërmerr çdo veprim të nevojshëm administrativ në kuptim të zbatimit të këtij vendimi sikurse përcaktohet në pikën II të dispozitivit, që të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

IV. Mbetet në fuqi Aktvendimi me Nr. 001-180/07, i datës 22.05.2025, i Njesisë së Personelit të Komunës së Junikut lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit.

V. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Kandidati për pranim në shërbim civil, E.H (tutje referuar: Ankuesi), me datë 25.06.2025, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit me numër protokollit 1-180/4329, të datës 11.06.2025, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare për procedurën e pranimit me numër reference RN00017614, për pozitën e punës Zyrtar i Logjistikës, të shpallur nga Komuna e Junikut dhe kundër Aktvendimit me Nr. 001-180/07, të datës 22.05.2025, të Njesisë së Personelit të Komunës së Junikut lidhur me refuzimin e aplikacionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Junikut, ndërsa, kjo e fundit ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje të drejtë dhe meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4341/2025 të datës 25.06.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Konkursin me Nr. reference: RN00017614 për pozitën Zyrtar i Logjistikës; Njoftimin e datës 22.05.2025 për verifikim paraprak; Vërtetim punësimi dhe letër rekomandim i datës 05.02.2023; Vërtetimin e lëshuar nga Posta për ankuesin lidhur me mbajtjen e praktikës; Vërtetim punësimi nga OJQ Balkan Promotin e datës 04.12.2017; Kërkesën për rishqyrtim të vendimit të datës 22.05.2025 Numri i lëndës: A.nr.3 3 /3 Datë: 3 .33.3) e parashtruar nga ankuesi më datë 27.05.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 30.05.2025 nga Zyra e Burimeve Njerëzore për ankuesin; Kërkesën për qasje në dokumente publike e datës 20.05.2025; Përgjigje në kërkesë nga Komuna e Junikut për ankuesin më datë 09.06.2025; Njoftimin e datës 11.06.2025 për shpalljen e rezultateve përfundimtare; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 29.07.2025; Listën e aplikantëve; Vendimin me Nr. 01/73 të datës 21.05.2025 për themelimin e Komisionit të Pranimit dhe akt emërimet/vendimet e anëtarëve të komisionit të pranimit; Aktvendimin e datës 22.05.2025 për refuzimin e aplikacionit të ankuesit; Formularin e vlerësimit të eses datë 04.06.2025; Formularët e vlerësimit të intervistë me gojë datë 11.06.2025; Aplikacionin e ankuesit i datës 11.05.2025 me dokumentacionet nga faqe 1-5; Aplikacionin e kandidati I.H të datës 07.05.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-27; Vendimin me numër protokollit 5257/2025 i e datës 06.08.2025 për zgjatjen e afatit për vendosje.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se pretendimet ankimore janë të pjesërisht të bazuara, **sepse:**

Rrethanat e Çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se:

- Komuna e Junikut më datë 11.04.2025 ka shpallur konkursin me nr.ref: RN00017614, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën e punës “Zyrtar i Logjistikës” në Drejtorinë e Administratës, klasa profesional 2, me afat aplikimi nga data 12.04.2025 deri më datë 11.05.2025.

-Në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej gjashtë (6) kandidatë, kurse sipas njoftimit të datës 22.05.2025, verifikimin paraprak e kanë kaluar vetëm dy (2) kandidatë.

-Më Aktvendimin Nr. 001-180/07, të datës 22.05.2025, të Njesisë së Personelit të Komunës së Junikut, ankuesit i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka përvojë pune prej një viti ashtu siç kërkohet me konkurs.

- Zyra e Personelit në Komunën e Junikut më datë 11.06.2025, ka publikuar njoftimin me numër protokoll 1-180/4329, lidhur më rezultatet përfundimtare, ashtu që, sipas këtij njoftimi kandidati I.H është shpallur si kandidat fitues më gjithsej 90.8 pikë të arritura.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundërshton ligjshmërinë e procedurës së pranimit me nr.ref: RN00017614, Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën e punës Zyrtar i Logjistikës, mbi bazën e pretendimeve të ka pas parregullsi të shumta dhe shkelje procedurale. Ankuesi shton se ka plotësuar kushtet e konkursit pasi që pas pranimit të vendimit për refuzim të aplikacion ka përcjell të gjitha dëshmitë mbi plotësimin e përvojës së punës, por që kërkesa për shqyrtim të këtyre dëshmime është refuzuar nga Komuna e Junikut. Me tej ankuesi pretendon se këto se kandidati fitues nuk plotëson kushtet e konkursit ngase nuk ka diplomë të studimeve themelore por ka vetëm diplomë të shkollës së mesme. Kërkon që rishikohet dosja e kandidatit fitues dhe të anulohet konkursi.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, ka vlerësuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurës e kontestuar, e në këtë kontekst kolegji ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit me numër reference RN00017614, ku si kërkesa të përgjithshme formale për pozitën përkatëse kanë qenë: Arsimimi i kërkuar: *Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), i paspecifikuar*. Diplomë e nivelit të pesë të KKK, për fushën e TIK. Përvoja e punës e kërkuar: *Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës*, si dhe Vendimin Nr. 01/73 të datës 21.05.2025, të Kryetari të Komunës së Junikut, për themelimin e Komisionin e Pranimit, dhe si rrjedhojë ka gjetur se komisioni në fjalë ka qenë në përbërje të rregullt nga: 1. A.K Kryesues; 2. S.I, anëtare; 3.S.K, anëtar;4. A.K, anëtare dhe 5. A.M, anëtar. Rrjedhimisht, sipas provave materiale të çështjes, Komisioni i Vlerësimit ka vepruar në përbërje të anëtarëve të rregullt, ashtu që, 1.Arton Krasniqi, sipas Vendimit nr.01/25, të datës 29.03.2023, ushtron pozitën e Zëvendësuesit të Zyrës së Personelit; 2. S.I sipas aktit të emërimit 1-180/2877, të datës 31.03.2023, ushtron pozitën e Udhëheqësit të Sektorit të Tatimit në Pronë; 3.S.K sipas Vendimit nr.prot:1-180/3457, të datës 14.05.2025, ushtron pozitën e ushtruesit të detyrës të Udhëheqësit të Sektorit të Gjendjes Civile; 4. A.K, sipas aktit të emërimit nr.prot:1-130/11402, të datës 11.12.2023, ushtron pozitën e Zyrtarit të Lartë për Buxhet dhe Financa dhe 5. A.M, sipas Vendimit nr.prot: 1-180/1825, të datës 01.03.2023, ushtron pozitën e zëvendësuesit të zyrtarit Certifikues Aprovues.

Rrjedhimisht, duke qenë së tre nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit janë ushtrues të detyrës, kolegji në kuptim të ushtrimit të autorizimeve ligjore, ka trajtuar çështjen e ushtruesit të detyrës vetëm mbi bazën e legjislacionit në fuqi gjegjësisht Ligjit Nr.08/L-/197 për Zyrtarët Publik (i aplikueshëm nga data 26.09.2023) si dhe referuar kohës nga shpallja e konkursit, andaj, mbi këtë bazë, Kolegji mori parasysh përcaktimet ligjore sipas nenit 35 të këtij ligji, i cili në mënyrë shprehimore parasheh se : *1 Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit. 3. Zyrtarja/i publik nuk mund të caktohet si ushtruese/i detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) mujor, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. 4. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni. 5. Çdo vendim i marrë nga ushtruesja/i i detyrës, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni, është i paligjshëm..”* dhe si rrjedhojë e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji konstaton së me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-/197 për Zyrtarët Publik institucionet publike përfshirë edhe Komunën e Junikut, kanë qenë të detyruar që ushtruesit e detyrave të pozitave të lira përkatëse ti bëjnë në pajtim me nenin 35 të këtij ligji, ndërsa, pozita e Udhëheqësit të Zyrës së Personelit dhe pozita e Zyrtarit Certifikues Aprovues nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë e deri në kohën e nxjerrjes vendimit për themelim të komisionit të pranimit janë mbajtur me zëvendësues sipas nenit 32.4 të Ligjit Nr.06/L-114 (i shfuqizuar me datë 25.09.2023) në kundërshtim të plotë me nenin 35 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, sepse instituti i zëvendësuesit të pozitës përkatëse nuk ka qenë i paraparë sipas këtij ligji, vetëm pozitat drejtuese mund të ushtrohet me ushtrues detyre e jo ato profesionale, dhe se pozita me ushtrues detyre nuk mund të ushtrohet më gjatë së 1 vit, andaj, mbi këtë bazë, kryesuesi A.K dhe anëtari A.M, nuk konsiderohet si persona me kompetencë ligjore për pozita përkatëse dhe si pasojë përbërja e Komisionit të Pranimit cilësohet në kundërshtim me nenin 40 paragrafi 2 të LZP.

Deri në këtë konstatim, Kolegji mori parasysh edhe qëndrimin juridik të Gjykatës Supreme, të dhënë në Aktgjykimin P.A.nr.07/2025, të datës 10.06.2025, ku ndër të tjera Gjykata Supreme ka konfirmuar se: *...”Nga kjo dispozitë rrjedh qartë se çdo akt juridik i nxjerrë nga një udhëheqës në cilësinë e ushtruesit të detyrës pas skadimit të afatit prej një viti është i pavlefshëm në thelb, për shkak të mungesës së kompetencës ligjore për të ushtruar funksionet që burojnë nga ajo pozitë..... Ligji i referohet pozitës si funksion institucional dhe jo individit si person. Pra, ndërrimi i personit nuk e ndërpret dhe nuk e rifillon afatin gjashtë mujor, përkatësisht njëvjeçar të ushtrimit të përkohshëm të pozitës. Kjo qasje është në përputhje me frymën e ligjit që kërkon stabilitet, profesionalizëm dhe përgjegjësi institucionale në udhëheqjen publike...”*

Rrjedhimisht, në kuptim të themelësisë së pretendimeve ankimore kolegji iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

-Nenit 9.1, ku përcaktohet se: 1. *Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj.*"

-Nenit 39 ku përcaktohet: *Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NJMBNJ-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përgjashtimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NJMBNJ e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNJ-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: **7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit;** dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimi i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit.*

-Nenit 40, më të cilin përcaktohet: *Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimi. 2. Komisioni i pranimi ka pesë (5) anëtarë/e, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/e civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/e nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/e i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale...."*

Po ashtu për vendosje të drejtë lidhur me çështjen ankimore, kolegji mori parash edhe përcaktimet sipas nenit 6, paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *2.Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor, kolegji ka analizuar Aktvendimin Nr. 001-180/07, e datës 22.05.2025, për refuzimin e aplikacionit të ankuesit, dhe si rrjedhë ka konstatuar se i njëjti është nxjerrë mbi një gjendje të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe zbatim drejtë të së drejtës materiale, sepse nga shqyrtimi i dokumentacionit të ankuesit i dorëzuar më rastin e aplikimit më datë 11.05.2025, i njëjti ka bashkangjitur Diplomën me Nr.1866/18 të datës 17.10.2018, të lëshuar nga Kolegji “AAB”, me të cilën dëshmohet se më datë 29.09.2018, ka përfunduar studimet themelore/ Baçelor (BA) në Marketing dhe Administrim Biznesi, ndërsa, lidhur me kriterin e përvojës së punës i njëjti në aplikacion nuk ka evidentuar ndonjë përvojë pune dhe po ashtu nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me përvojën e punës së kërkuar sipas konkursit, ndërsa, referuar të dhënave nga Trusti, të siguruar nga vet organi i punësimit përmes ekosova si pjesë integrale e SIMBNJ, rrjedhë se ankuesi ka të paguara kontributet nga biznesi VM3 SHPK dhe atë vetëm për muajin shtator dhe tetor 2018. Pra, sipas pasqyrës së Trustit nuk identifikohet se në çfarë pozitë ka punuar pranë këtij biznesi. Mbi këtë gjendje të fakteve rezulton se Njësia e Personelit në Komunën e Junikut, ka vepruar konform nenit 39, paragrafi 7, nën paragrafi 7.1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 7, paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, kështu që, pretendimi i ankuesit mbi këtë shkak është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin së kandidati fitues nuk ka diplomë të studimeve, Kolegji bazuar në shqyrtimin e dëshmive të dorëzuara nga kandidati fitues më rastin e aplikimit më datë 07.05.2025, ka gjetur se kandidati fitues posedon Diplomën e lëshuar nga Kolegji “Fama”, me të cilën dëshmohet se më datë 28.12.2021, ka përfunduar studimet themelore/Bachelor i Arteve në Ekonomik me specializim në Menaxhment, ndërsa lidhur me përvojën e punës pas diplomimit ka ofruar si dëshmi Referencën e Punës të datës 15.01.2025, të lëshuar nga Biznesi Fresh BOXX Sh.P.K, me të cilën konfirmohet së ka qenë i punësuar pranë kësaj kompanie në periudhën kohore nga 01.11.2023 deri 30.04.2024, si Zyrtar i Logjistikës si dhe Referencën e punës të datës 01.05.2025, të lëshuar nga biznesi ARBTEC DHKP, me të cilën konfirmohet se ka qenë i punësuar pranë kësaj kompanie në pozitën e Mbikëqyrësit të Makinerive (Logjistikë) dhe atë në periudhën 18.06.024 deri 30.04.2025, përvojë të cilën e ka të shoqëruar edhe më Pasqyrën e TRUSIT.

Andaj, referuar konstatimit si më sipër, gjegjësisht, duke qenë së emërimi i Komisionit të Pranimit nuk ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore, në vlerësimin e Kolegjit çdo veprim administrativ i ndërmarr nga ky i fundit konsiderohet si veprim i paligjshëm, në kuptim të nenit 52 paragrafi 1. pika 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që, duke qenë së nuk janë gjetur shkelje lidhur me shpalljen e konkursit dhe në fazën e verifikimit paraprak, Kolegji duke u bazuar në nenin 18, paragrafi, 1 nën paragrafin, 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht, aprovoj pjesërisht si të bazuar ankesën, anuloi të gjitha veprimet e ndërmarra në fazën e vlerësimit profesional, duke kthyer çështjen më fillim në fazën e vlerësimit profesional, me detyrimin që Kryetari i Komunës së Junikut në pajtim me dispozitat materiale të themeloj Komisionin e Pranimit, përgjegjës për zhvillimi e vlerësimit profesional të kandidatëve të përfshirë në listën e ngushtë dhe la në fuqi Aktvendimin Nr. 001-180/07, të datës 22.05.2025, të Njesisë së Personelit të Komunës së Junikut lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1226/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit E.H;
- Komunës së Junikut: Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Personelit
- Arkivit të KPMSHCK-së.